VENDIM
Nr. 704, datë 13.11.2024

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, JOPUBLIK, TË LLOJIT AKADEMI, "*AMERICAN ACADEMY OF TECHNOLOGY TIRANA"*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, 30 dhe 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, të llojit akademi, "*American Academy of Technology Tirana"*, në vijim Akademia "*American Academy of Technology Tirana"* (AATT), në emër të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan *"Harry T. Fultz",* i cili ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. Akademia *"American Academy of Technology Tirana"* organizohet në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Teknologjisë dhe ka në përbërje njësitë bazë, si më poshtë vijon:
   a) Departamentin e Inxhinierisë Elektrike;
   b) Departamentin e Teknologjisë së Informacionit;
   c) Qendrën Kërkimore Shkencore.
3. Akademia "*American Academy of Technology Tirana"* ofron programe të studimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
4. Akademia *"American Academy of Technology Tirana"* fillon veprimtarinë vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë.
5. Akademia *"American Academy of Technology Tirana"* duhet t'u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Statuti i Akademisë *"American Academy of Technology Tirana"* miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.
7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
8. Çdo ndryshim i njësisë kryesore të Akademisë *"American Academy of Technology Tirana"* miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas legjislacionit në fuqi.
9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan *"Harry T. Fultz"* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama